



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë  
Agencija a Hranu i Veterinarstvo  
Food and Veterinary Agency

## NJOFTIM PËR PUBLIKIM

*Kontratë për autorizim të operatorëve ekonomik  
Furnizim me numra të matrikulimit të kafshëve*

Data e përgatitjes së njoftimit: 13.02.2024

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

#### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: AGJENCIA E USHIMIT DHE VETERINARISE		
Adresa Postare: Zona Industriale p.n - Fushë Kosovë Prishtinë – nr. 237		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10 000	Vendi:
Personi kontaktues: Drejtorja e Shëndetit dhe Mirëqenës së Kafshëve		Telefoni: +383 38 200 38 324
Email: infoauv@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		www.auv-ks.net

### NENI II: LËNDA E KONTRATËS

#### II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës nga autoriteti kontraktues për autorizim të operatorëve ekonomik: <i>Autorizimi i operatorëve ekonomik për furnizim me numra të matrikulimit të kafshëve</i>
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit Kontrate Publike - Autorizim, Lokacioni: Vendi i mbajtjes së numrave është vendi ku operatorët

ekonomik të autorizuar operojnë. Veterinarët e kontraktuar do të njoftohen me shkrim për adresën e furnizimit të numrave të kafshëve.

### II.1.3) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës:

*Autorizimi i operatorëve ekonomik për furnizim me numra të matrikulimit të kafshëve (gjedheve, deleve, dhive, derrave etj.*

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)

Vërejtje: *Autorizimi i operatorëve ekonomik për furnizim me numra të matrikulimit të kafshëve (gjedheve, deleve, dhive, derrave etj. ) – Numrat do të jenë në dispozicion nga operatorët ekonomik të autorizuar çdo herë deri në përfundimin e kontratave të cilat do të jenë me afat deri në 5 vite varësisht nga politikat e autoritetit kontraktues se si përcaktohen. Kontratat do të jenë me mundësi të shkëputjes pa paralajmërim nëse autoriteti kontraktues vëren që ka devijime të kontratës apo mos respektim të saj.*

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj *apo ditë* nga dhënia e kontratës: **Fillimi do të jetë ditën e nënshkrimit të kontratës dhe do të përfundoj varësisht prej viteve të cilat caktohen gjatë negociimit mes OE dhe AK.**

## III.1) KUSHTET PËR PJESËMARRJE TË OPERATORËVE EKONOMIK

### III.1.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

**Kërkesa 1.** Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;

**Kërkesa 2.** Certifikata e regjistrimit të TVSH-së

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Evidenca 1:** Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit më numër unik identifikues

**Evidenca 2:** Kopja e Certifikatës e TVSH-së

### III.1.2) Përshtatshmëria profesionale:

**Kërkesa 1.** Deklarata nën betim

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Evidenca1.** Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga operatori ekonomik duke e përdorur një formë të cilën do e dërgojmë kur iu dërgohen oferta.

**Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë** që kërkohen nga operatorët ekonomik që propozohet që të shpërblehet me kontratë për autorizim e që duhet të sillen para publikimit të njoftimit për operatorët e suksesshëm:

1. Vërtetim të lëshuar nga gjykata komerciale apo autoritetet administrative të vendit të

themelimit të tenderuesit - kërkohet origjinali ose kopja e noterizuar)

2. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit, si dhe që nuk ka borje ose obligime tatimore deri në tre mujorin e fundit të vitit - kërkohet origjinal.

**Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontrate të sjelle dokumentet të kërkuara në pikën, 1 dhe 2 i jep të drejte Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhe.**

Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre

### **III.1.3) Kapaciteti teknik dhe profesional**

Te gjithë Operatorët Ekonomik të interesuar duhet të ofrojnë dëshmi për kërkesat e mëposhtme;

**Kërkesa 1.** Operatori Ekonomik duhet të ofroj mostra së bashku me përshkrimin e të gjitha llojet e numrave të kafshëve shtëpiake (gjedhe, dele, dhi, derra etj.) me të cilat do të autorizoheni. Mostrat së bashku me katalog duhet të dorëzohen në forme fizike në zarf të mbyllur së bashku me ofertën. Në zarf të shkruhet për AUV, Titulli i kontratës, numri i kontratës dhe Emri i Operatorit ekonomik;

**Kërkesa 2.** Operatori ekonomik duhet të dorëzojnë dëshmi që numrat e matrikullit janë sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

**Kërkesa 3.** Operatori ekonomik duhet të deklarohet me deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe të vulosur që në stoqet në rastin e porosive të sigurohen numrat në afatin kohorë jo më shumë se sa 50 ditë;

**Kërkesa 4.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të çmimit referent me të gjitha taksat e aplikuar në Republikën e Kosovës të secilit pozicion të numrave (gjedhe, dele, dhi dhe derra, etj) sipas specifikacionit teknik që do të ketë në dispozicion gjatë realizimit të kontratës. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka të drejtë të kërkojë çfarëdo informacioni rreth çmimit për copë të numrit dhe po që se vëren që çmimet nuk janë çmime të tregut në mënyrë automatike do të refuzojë ofertën e juaj.

**Kërkesa 5.** Operatori ekonomik duhet të ofroj me shkrim deklaratën të nënshkruar dhe të vulosur që specifikacioni teknik i ofruar është në përputhshmëri të plotë me specifikacionin teknik i kërkuar nga autoriteti kontraktues e që si i tillë është i bashkangjitur me këtë njoftim.

**Kërkesa 6.** Operatori ekonomik duhet të ofroj analizat apo A-testet e matrikujve (plastikes) nga vendi i prodhimit të cilat dëshmojnë se numrat nuk dëmtojnë shëndetin e kafshës.

Dokumentet e kërkuara (dëshmitë)

**Evidenca 1.** Katalogët së bashku me mostrat e numrave të kafshëve shtëpiake (gjedhe, dele, dhi, derra etj);

**Evidenca 2.** Operatori ekonomik duhet të dorëzojnë dëshminë me shkresë përcjellëse nga vendi i prodhimit që numrat janë sipas standardeve të Bashkimit Evropian;

**Evidenca 3.** Deklaratë me shkrim që në stoqe do të kenë numrat kur kërkohen nga veterinarët e kontraktuar jo më vonë se sa 50 ditë;

**Evidenca 4.** Deklaratë me shkrim të çmimeve referente më të gjitha taksat e aplikuara në Republikën e Kosovës;

**Evidenca 5.** Deklaratë me shkrim që specifikacioni i ofruar për numrat është në përputhshmëri të plotë me specifikacionin e kërkuar që do të jetë pjesë e këtij njoftimi gjegjësisht në fund të njoftimit tek informatat shtesë.

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës	
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur	
<input checked="" type="checkbox"/> E negociuar	Nëse autoriteti e sheh të nevojshme operatorët ekonomik mund të ftohen për ndonjë negociatë rreth specifikimit teknik, mostrave apo edhe çmimit referent.

### IV.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

#### IV.2.1) Afati i fundit për pranim të *operatorëve ekonomik*:

*Data: 28.02.2024 koha: 11:00 në adresën vendi: Zona Industriale p.n - Fushë Kosovë Prishtinë - nr. 237 – me ofertë duhet të dorëzohen edhe mostrat e numrave.*

#### IV.2.1) Takimi për hapjen e tenderëve: Nuk do të ketë hapje publike të ofertave.

*Për arsye se nuk ka çmime që autoriteti kontraktues do të paguaj, përveç çmimit referent që kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas kërkesës 4 të shënuar me lartë.*

### V.1) INFORMACIONET SHITESË

**Shënim:** Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga personat e autorizuar të operatorëve ekonomik.

Gjithashtu më poshtë është paraqitur specifikacioni teknik i detyrueshëm i llojit të numrave dhe përshkrimi i tyre që operatorët ekonomik duhet ti përmbahen me përpikëri:

Artikulli 1 - Numra te identifikimit (matrikullit) te **gjedheve**, dimensionet :

A-Femra -	Lartësia	76-79 mm
	Gjerësia	55-57 mm
B- Mashkulli -	Lartësia	55-60 mm
	Gjerësia	54-57 mm

Sqarim :Maja e matrikullit mashkull duhet të jetë nga metali e mbuluar me plastik .

Matrikulli femër duhet të jetë me koke të mbyllur.

Numrat, logoja dhe bar kodi duhet te printohen me laser me qëndrueshmëri te larte ( rezistent ndaj kushteve atmosferike ) .

Matrikulli duhet te jete me ngjyrë te verdhe, duhet të vendoset në dy veshët e një kafshe me njëjtin barkod, shenjen RKS dhe tetë (8) numra unik të jene të vendosur në matrikull.

**Gjedheve (p.sh RKS-1-1- 000000 )**

**Shteti RKS,Lloji i kafshës1,**

**Regjioni 1,2,3,4,5,6,7 dhe nr rendor te matrikullave)**

**Megjithatë dizajnin dhe përshkrimin në numrin e matrikullit e përcakton autoriteti kontraktues e që operatori ekonomik i autorizuar duhet ti përmbahet me përpikëri.**

Artikulli 2 - Numra te identifikimit (matrikullit) të **deleve, dhive dhe derrave**,etj, dimensionet :

A-Femra	Lartësia	43- 46 mm
	Gjerësia	35- 38 mm
B- Mashkulli	Lartësia	43- 46 mm
	Gjerësia	35- 38 mm

Sqarim :Maja e matrikullit mashkull duhet të jetë nga metali e mbuluar me plastik.

Matrikulli femër duhet të jetë me kokë të mbyllur.

Numrat, logoja dhe bar kodi duhet te printohen me laser me qëndrueshmëri te larte ( rezistent ndaj kushteve atmosferike ) .

Matrikulli duhet te jete me ngjyrë te verdhe, duhet të vendoset në dy veshët e një kafshe me njëjtin barkod, shenjen RKS dhe tetë (8) numra unik të jene të vendosur në matrikull.

**Deleve (p.sh RKS-2-1-000000).**

**Dhive (p.sh RKS-3-1-000000).**

**Derrave (p.sh RKS-4-1 -000000).**

**Shteti RKS,Lloji i kafshës,2,3,4 etj Regjioni 1,2,3,4,5,6,7 dhe nr rendor te matrikullave)**

**Megjithatë dizajnin dhe përshkrimin në numrin e matrikullit e përcakton autoriteti kontraktues e që operatori ekonomik i autorizuar duhet ti përmbahet me përpikëri.**